

ABSTRAKTI

“ANALIZA E STRUKTURËS SE TË HYRAVE TATIMORE NË KOSOVË PËR PERIUDHËN 2010 – 2020”

Tatimet përbëjnë një pjesë të madhe të të hyrave buxhetore në Kosovë prandaj sistemi i taksave është shumë i rëndësishëm, pasi që Kosova mbetet një vend në zhvillim. Kosova ka një ekonomi të vogël, dhe të hapur. Nuk është e vështirë për të shpëtuar ligjet e pafavorshme tatimore duke lëvizur nga një vend fqinj në vend tjetër. Kështu tatimet nuk mund të ndryshojnë në ndonjë masë të madhe në krahasim me vendet e tjera fqinje, pa u përballur me rrezikun e një migrimi të lartë. Kosova ka një sistem të thjesht tatimorë dhe taksa të ulët, normat e tatimeve ndoshta janë tashmë ndër më të ulëtat në rajon. Tatimet janë instrumenti themelor financiar i sigurimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit. Roli i tyre ka ndryshuar historikisht me ndryshimin e natyrës dhe të funksioneve të shtetit, si nga instrumenti financiar me anë të të cilit shteti siguronte flukse financiare hyrëse, të ardhura për të përballuar disa shpenzime të veta, kryesisht ushtarake, gjyqësore dhe administrative, në tatimet që sot shteti i përdorë si një mjet jashtëzakonisht efikas duke realizuar shumë qëllime të politikës së tij ekonomike, sociale, arsimore, shëndetësore, etj.

Qeveria e Kosovës është angazhuar të ndërtoj një sistem tatimor konkurrent, që ka mundësuar rritjen e të ardhurave. Përparim i mirë në këtë drejtim është bërë në reformimin e sistemit tatimor. Kjo temë fokusohet në një seksion të veçantë për tatimet në përgjithësi, llojet e tatimeve, karakteristikat, tatimet në formim e buxhetit etj. Sistemi tatimor në Kosovë përbën një pako ligjesh tatimore dhe udhëzimesh administrative. Ky hulumtim është kryer duke përdorur një metodologji cilësore. Ajo kombinon rishikimin e literaturës dhe analizën e sistemit tatimor por edhe të hyrave tatimore në vendin tonë, në bazë të publikimeve nga institucionet kompetente.